



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEĆA KOSOVA

Numri: KSC-BC-2020-06/IA023

Vendosi: Kryetarja e Dhomave të Specializuara
Gjykatëse Ekaterina Trendafilova

Administratore: Fidelma Donlon

Data: 30 qershor 2022

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Publik

Vendim për Caktimin e Panelit të Gjykatës së Apelit

Gjykatësve të Panelit të Gjykatës së Apelit:

Gjykatëse Mishelë Pikar

Gjykatës Emilio Gati

Gjykatëse Nina Jorgensen

Mbrojtjes së Hashim Thaçit:

Gregori Kihou

Mbrojtjes së Kadri Veselit:

Ben Emerson

Zyrës së Prokurorit të Specializuar:

Xhek Smith

Mbrojtjes së Rexhep Selimit:

Dejvid Jang

Mbrojtësit të viktimave:

Sajmon Loz

Mbrojtjes së Jakup Krasniqit:

Venkatesvari Alagendra

KRYETARJA e Dhomave të Specializuara (“Kryetarja”), duke vepruar në bazë të neneve 33(1)(c) dhe 45(2) të Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar, rregullave 77, 169 dhe 170(2) të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës (“Rregullorja”) dhe rregullave 3 dhe 4 të Rregullores për Caktimin e Gjykatësve të Dhomave të Specializuara nga Regjistri i Gjykatësve Ndërkombëtarë (“Rregullorja për Caktimin e Gjykatësve”), me anë të këtij vendimi cakton një Panel të Gjykatës së Apelit pas lëshimit nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake të Vendimit mbi Kërkesën e Mbrojtjes së Veselit për Leje për Apelim të Vendimit të Tretë mbi Pjesëmarrjen e Viktimave (“Vendimi për Miratimin e Lejes për Apelim”).¹

I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 25 maj 2022, Gjykatësi i Procedurës Paraprake lëshoi Vendimin e Tretë mbi Pjesëmarrjen e Viktimave,² ku pranoi pjesëmarrjen e 12 viktimave në proces dhe miratoi mosnxjerrjen e identitetit të tyre për publikun dhe palët (“Vendimi i Kundërshtuar”).³

2. Më 1 qershor 2022, z. Kadri Veseli kërkoi leje për të apeluar Vendimin e Kundërshtuar.⁴

3. Më 28 qershor 2022, Gjykatësi i Procedurës Paraprake lëshoi Vendimin për Miratimin e Lejes për Apelim, ku, ndër të tjera, miratoi, pjesërisht, kërkesën e z. Veseli për leje për apel.⁵

¹ F00856, Vendim mbi Kërkesën e Mbrojtjes së Veselit për Leje për Apelim të Vendimit të Tretë mbi Pjesëmarrjen e Viktimave, 28 qershor 2022.

² F00817, Vendimi i Tretë mbi Pjesëmarrjen e Viktimave, 25 maj 2022 (rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*). Versioni i redaktuar publik i Vendimit të Kundërshtuar u dorëzua po atë ditë. Shih F00817/RED.

³ Vendimi i Kundërshtuar, para. 29-33, 43-46, 50(a), (e).

⁴ F00828, Vendim mbi Kërkesën e Mbrojtjes së Veselit për Leje për Apelim të Vendimit të Tretë mbi Pjesëmarrjen e Viktimave, 1 qershor 2022.

⁵ Vendimi për Miratimin e Lejes për Apelim, para. 50.

II. CAKTIMI

4. Pas shqyrtimit të kriterëve të përcaktuara në rregullën 4 të Rregullores për Caktimin e Gjykatësve, duke përfshirë përvojën dhe kompetencën përkatëse, si edhe disponueshmërisë në këtë moment,

KRYETARJA ME KËTË VENDIM CAKTON:

Gjykatësen Mishelë Pikar

Gjykatësin Emilio Gati

Gjykatësen Nina Jorgensen

në Panelin e Gjykatës së Apelit për të vendosur mbi apelin
në pajtim me Vendimin për Miratimin e Lejes për Apelim

/nënshkruar/

**Gjykatëse Ekaterina Trendafilova,
Kryetare e Dhomave të Specializuara**

E enjte, 30 qershor 2022
Në Hagë,
Holandë